



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 1976/1 Prot.

Tiranë, më 07.07.2022

V E N D I M

Nr. 36 datë. 07.07.2022

“PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË Z. EDUARD DUKAJ NË VENDIN VAKANT
PËR INSPEKTOR JOMAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I
DREJTËSISË NË DATË 30.09.2021”

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Z. Besnik Maho – Kryetar
Znj. Joana Asimi – Anëtar
Z. Julian Zonja- Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Alma Zili
Znj. Eljona Bylykbashi
Znj. Jetmira Saraçi

Në mbledhjen e datës 07.07.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit për inspektor jomagjistrat: Z. Eduard Dukaj

OBJEKTI: Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të z. Eduard Dukaj, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.

Komiteti pasi u njoh me aktet si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të

kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 30.09.2021, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 9 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.

2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 29.10.2021, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 08.11.2021, ku vendosi për radhën e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën “Njoftime”; “Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë” listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”.
4. Z. Eduard Dukaj, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin nëpërmjet kërkesës me nr. 3926 prot., datë 21.10.2021 për vendin vakant të Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës bazuar në detyrimet ligjore, të përcaktuara nga neni 209, neni 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si dhe urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në datën 10.11.2021, kandidati Eduard Dukaj, është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.
6. Në datën 25.11.2021 kandidati Eduard Dukaj ka depozituar tek sekretariati teknik, formularët e deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllime të vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.
7. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit A, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", me shkresën përcjellëse me nr. 4228 prot. datë 26.11.2021, i ka dërguar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), listën e kandidatëve dhe të personave të lidhur me ta, sikurse janë deklaruar prej vetë kandidatëve, që i nënshtrohen procedurës së deklaramit dhe kontrollit të pasurisë, si edhe kopjet e deklaratave të nënshkruara nga secili prej tyre.
8. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", ligjit nr.9367 date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar.
9. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Eduard Dukaj, ku deklarohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.
10. Me shkresën nr. 4570/1 prot, datë 24.12.2021, prot ILDKPKI ka informuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë së kandidati Eduard Dukaj, e ka përmbushur detyrimin për të dorëzuar të plotësuar Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

11. ILDKPKI, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 668/24 prot., datë 07.02.2022, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e përfundimit të kontrollit të ushtruar për kandidatin Eduard Dukaj dhe personat e lidhur me të.
12. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, si dhe në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", ky institucion kryen verifikime pranë subjekteve publike dhe private që lejon ligji, të të dhënave mbi pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatis Eduard Dukaj dhe personave të lidhur me të si dhe administron/analizon të dhënat që dalin nga procesi i verifikimit të kriterit të pasurisë.
13. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatis Eduard Dukaj, referuar aktit të përfundimit të kontrollit të deklaratës së pasurisë rezultojnë se ILDKPKI-ja me shkresën nr. 668 prot., datë 17.12.2021, i është drejtuar me kërkesa për informacion lidhur me kandidatin Eduard Dukaj institucioneve: *Banka e Shqipërisë, Banka Raiffeisen sha, Banka Kombëtare Tregtare sha, Banka Intesa Sanpaolo sha, Banka Alpha sha, Banka Tirana sha, Banka e Bashkuar e Shqipërisë sha, Banka ProCredit sha, Banka e Parë e Investimeve sha, Banka Amerikane e Investimeve sha, Banka Credins sha, Banka Union sha, Banka OTP Albania sha, Raiffeisen Leasing sha, Porsche Leasing sha, RFZ Invest sha, Credins Invest sha, DPSHTRR, Qendra Kombëtare e Biznesit, DPT, ISSH, D.P Detare, ASHK online.*
14. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, të përcaktuara në nenin 209, pika 6, germa "a" dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit C, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", kandidati Eduard Dukaj ka depozituar diplomë nr. 561 datën 04.07.2007 të arsimit të lartë lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër, ku vërtetohet se ka marrë titullin "Jurist" gjatë viteve 2003-2007. Kjo diplomë, referuar nenit 124/2 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), sipas parimeve të procesit të Bolonjës, është ekuivalente me diplomat "Master i shkencave".

15. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Eduard Dukaj, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "b", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 4268 prot, datë 02.12.2021*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 4263 prot, datë 02.12.2021*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 4265 prot, datë 02.12.2021*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr.4269 prot, datë 02.12.2021*).
16. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht (*me shkresën nr.28 prot., datë 06.01.2022, shkresën nr. 4620/2 prot., date 28.12.2021, shkresën nr.6711 /17 prot., datë 16.12.2021 dhe shkresën nr.1157 prot., datë 10.12.2021*).
17. Në mbështetje të nenit 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me shkresën me nr. 4264 prot., datë 02.12.2021 është kërkuar informacion që lidhet me integritetin e secilit prej kandidatëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. 4260 prot., datë 02.12.2021 Prokurorisë të Përgjithshme dhe me shkresën nr. 4261 prot., datë 02.12.2021 Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me:
- Çdo të dhënë apo indicie të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin të ligjit material dhe procedural mbi të cilin ushtron veprimtarinë ky institucion kushtetues;
 - Kopje të dokumentacionit që përmban të dhëna në rastet e identifikimit të kandidatit jo magjistratë në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale), ku përfshihen edhe biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike;
 - Nëse janë zhvilluar ndaj tyre procese gjyqësore të karakterit penal, dhe rezultojnë të dënuar, për efekt të gjendjes gjyqësore.
18. Informacioni i kërkuar për sa më sipër, është përcjellë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 9874/1 prot., datë 14.12.2021 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, shkresën nr. 13028/1 prot., datë 10.12.2021 të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve dhe shkresën nr. 1689/4 prot., datë 10.12.2021 të Prokurorisë të Përgjithshme.
19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, që kanë të bëjnë me përvojën profesionale si "Jurist", jo më pak se pesëmbëdhjetë vite punë në çastin e kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "c", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me

kërkesë për informacion Institutit të Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. 4259 prot, datë 02.12.2021 dhe me shkresën nr. 214 prot, datë 27.01.2022, në lidhje me periudhën e derdhjes të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7674/1 prot, datë 13.12.2021, shkresën nr. 12854/1 prot, datë 16.12.2021 dhe me shkresën nr. 1108/1 prot, datë 10.02.2022.

20. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë me nr. 4266 prot., datë 02.12.2021. Kërkesa është bërë në mbështetje të nenit 209, pika 6, germa "ç", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", duke kërkuar nëse kandidati, në mënyre aktive, ka ushtruar profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjigjur me shkresën nr. 333 prot., datë 22.12.2021 (informacion i cili është administruar në dosjen e kandidatit).

21. Lidhur me kriterin e përcaktuar në nenin 209, pika 6, germa "d" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar është dërguar shkresa nr.4261, datë 02.12.2021 në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ku është kërkuar informacion nëse kandidati është dënua më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale. Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve ka kthyer përgjigje pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 13028/1 prot., datë 10.12.2021.

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "e", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe pikës 62, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit nëse secili kandidat, përfshihet në rastin e posaçëm të nenit 209, pika 6, germa "e", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, nëse kandidati: "e) ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991" apo në njërën nga rastet e pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë."

Me shkresën nr. 4262 prot, datë 02.12.2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati i sipërcituar, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1886/1 prot, datë 31.12.2021, ka dërguar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin, i cili është bashkëngjitur praktikës së kandidatit (*Vendim nr.544, datë 29.12.2021* i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit).

24. Në vijim të procedurave të verifikimit që lidhet me integritetin e kandidatëve për inspektor jomagjistratë si dhe për të shmangur çdo lloj konflikti interesi që bie ndesh me nenin 209, pika 6, geramat "dh", "ë" dhe "f" të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", është njoftuar zyrtarisht secili kandidat që të plotësojë formularët përkatës që lidhen me:

- mospasjen e funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- mosqenien bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
- mosqenien anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

Për sa i takon kandidatit Eduard Dukaj, është paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ka dorëzuar të plotësuar secilin prej formularëve të mësipërm.

25. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", të ndryshuar, pikës 27 e vijues, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "*Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit*", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "*Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"*", Komiteti ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm.

26. Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", të ndryshuar, të C, të Kreut IV vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "*Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit*", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "*Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"*", Kryetari i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 06.07.2022, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e aplikimit të kandidimit të z.Eduard Dukaj, për vendin vakant për inspektor jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komitetit

27. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë nga aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Eduard Dukaj për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
28. Në ligjin nr.115/2016 " Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar konkretisht në nenin 209, në pikën 6, përcaktohen "Kushtet për inspektor jomagjistrat", si vijon:
6. *Kandidatët për inspektorë, të cilët nuk janë magjistratë, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:*
- a) *të jenë shtetas shqiptarë me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;*
 - b) *të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;*
 - c) *në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet;*
 - ç) *në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit të paktën 2 vitet e fundit;*
 - d) *të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e nje krimi;*
 - dh) *të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;*
 - e) *të mos kenë qenë anëtare, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991;*
 - ë) *të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;*
 - f) *të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit;*
29. Përsa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar nga ana ILDKPKI-së, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 668/24 prot., datë 07.02.2022, ka dërguar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e përfundimit të kontrollit të ushtruar për kandidatin Eduard Dukaj dhe personat e lidhur me të.
30. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruar nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Eduard Dukaj, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;

b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë/transaksionet:

- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

31. Sikurse rezulton me aktin nr. 668/24 prot., datë 07.02.2022, për kandidatin Eduard Dukaj, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së janë në disfavor të tij, në lidhje me plotësimin e kriterit të pasurisë në dy aspekte që lidhen me deklarimin jo të saktë në përputhje me ligjin si dhe mungesën e dokumentacionit ligjor për të justifikuar pasurinë/transaksionet.
32. Bazuar në përgjigjen e dhënë nga ILDKPKI me aktin nr. 668/24 prot., datë 07.02.2022, Komiteti ka vendosur me aktin nr.4228/13, datë 23.02.2022, që t'i përcillen kandidatit Eduard Dukaj, rezultatet e kontrollit të pasurisë për sa më sipër duke i lënë një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh për të dhënë sqarime dhe dokumentacion shtesë, me qëllim për të kundërshtuar gjetjet e ILDKPKI-së. Njoftimi i rezultatit të kontrollit të pasurisë i është njoftuar kandidatit Eduard Dukaj me emailin e datës 23.02.2022 (i cili administrohet në dosjen e aplikimit të kandidatit).
33. Me e-malin e datës 30.03.2022, kandidati Eduard Dukaj, ka njoftuar nëpërmjet adresës elektronike, se ka paraqitur me detaje çdo dokument të kërkuar nga ILDKPKI-ja, gjatë procedurës të verifikimit të kriterit të pasurisë. Ai deklaron se është një qytetar i lirë me të drejta të plota të pakushtëzuara, se i ka shërbyer vetes dhe familjes, se ka dorëzuar në mënyrë të plotë dhe të rregullt çdo dokument të kërkuar nga ana e ILDKPKI-së dhe se është mëse i bindur dhe i vetëdijshëm që ka zbatuar ligjin 100%.
34. Në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 " Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të pikës 54 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Komiteti vjen në përfundimin se kandidati Eduard Dukaj nuk ka "kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij". **Për rrjedhojë, për sa më sipër, ky kandidat gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit pasi nuk plotëson kriterin e verifikimit të pasurisë.**
35. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "a" e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të "a) të jetë shtetas shqiptar me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;" nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Eduard Dukaj, ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në sezonin e verës të vitit mësimor 2006-2007 si Jurist, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, fakt ky që provohet nga diploma nr. 561 datën 04.07.2007. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të

lartë në Republikën e Shqipërisë” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidati Eduard Dukaj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

36. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa “b” e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati “b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale”. Nga aktet e administruara në dosjen e aplikimit, si dhe bazuar në rezultatet e arritura nga kandidati në përfundim të arsimit të lartë ku ka fituar titullin “Jurist” ashtu edhe në Master Shkencor, kandidati Eduard Dukaj e plotëson këtë kriter.
37. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidati Eduard Dukaj ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të cilin, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
38. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1689/4 prot., datë 10.12.2021, ka dërguar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Eduard Dukaj, përmes vendimit të datës 10.12.2021. Në bazë të pikës 4.2.2 të vendimit të sipërcituar, mbahet qëndrimi se *“indiciet, të dhënat apo faktet që i atribuohen personit/subjektit të ligjit për dënimet penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar apo dëbime nga territori i një shteti, janë të domosdoshme ligjërisht, pasi vetëm mbi bazë të tyre mund t'i kërkohet autoriteteve të huaj policore dhe gjyqësore, informacion dhe dokumenta, nga të cilat mund të paraqitën rrethana që përfshihen brenda ndalimeve të parashikuara nga ligji nr. 138/2015”*. Për këtë shkak, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur mospranimin e kërkesës të ILD-së, për verifikim të të dhënave të pasqyruara në Formularin e Vetëdeklarimit të datës 25.11.2021 nga personi/subjekti Eduard Dukaj kandidat për pozicionin e inspektorit jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
39. Në mbështetje të nenit 209, pika 6, gjerat "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me shkresën me nr. 4264 prot., datë 02.12.2021 është kërkuar informacion që lidhet me integritetin e secilit prej kandidatëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Me shkresën me nr. 9874/1 prot., datë 14.12.2021, kjo Prokurori ka dërguar informacionin se për z. Eduard Dukaj, kandidat për pozicionin e inspektorit jomagjistrat, nuk rezultojnë të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
40. Referuar nenit 209, pika 6, gjerës "b" të ligjit nr. 115/2016, Komiteti vjen në përfundimin se kandidati Eduard Dukaj, krahas plotësimit të saktë formularit të vetëdeklarimit, nuk u vu në dijeni të ndonjë indicieje, të dhëne apo fakteve që i atribuohen këtij kandidati për dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar apo dëbime nga

territori i një shteti. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

41. Gjithashtu, për të verifikuar çdo të dhënë tjetër që lidhet me integritetin, bazuar në nenin 209, pika 6, germa "b" e ligjit nr. 115/2016, Komiteti verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organet kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidati *"ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar"*.

Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standard dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

42. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr.4620/2 prot., date 28.12.2021, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin e kërkuar, të cituar më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Eduard Dukaj:

"a) Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale, apo të kenë lidhje kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë me krimin e organizuar në ngarkim të z Eduard Dukaj."

43. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.28 prot., datë 06.01.2022, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Eduard Dukaj:

"a) Nuk disponon të dhëna informacione për përfshirjen në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme dhe që bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 38 të ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe pikën 66, gerrat a) dhe c) të VKM nr. 536, datë 25.07.2019 "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotë të kushteve dhe kriterëve ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë të kandidatëve jo magistratë për pozicionin e inspektorit në ngarkim të z Eduard Dukaj."

44. Shërbimi Informativ i Shtetit, me shkresën nr.6711/17 prot., datë 16.12.2021, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga

agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Eduard Dukaj:

“a) Nuk disponohen të dhëna dhe informacione për përfshirje në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare, apo aktivitete të kundraligjshme në ngarkim të z. Eduard Dukaj”.

45. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me shkresën nr.1157 prot., datë 10.12.2021, ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Eduard Dukaj:

“a) Nuk disponohen të dhëna dhe informacione për përfshirje në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare, apo aktivitete të kundërligjshme në ngarkim të z. Eduard Dukaj”.

46. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa “b” të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

47. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "c" e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidatët *“c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet”*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, gjatë procesit të verifikimit rezulton se kandidati ka dorëzuar librezën e punës dhe jetëshkrimin me anë të së cilave do të duhet të vërtetohej përvoja e punës si jurist të paktën 15 vite. Nga dokumentacioni i përcjellë në momentin e aplikimit dhe dokumentacioni shtesë të kërkuar nëpërmjet email datë 16.11.2021 (përcjellë me email më datë 18.11.2021, i cili administrohet në dosjen e kandidatit), rezultojnë këto periudha punësimi:

- Jurist, Drejtoria e Shëndetit Publik për periudhën 15 Prill 2008-20 Gusht 2008;
- Specialist, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë për periudhën 20 Gusht 2008- 17 Dhjetor 2013;
- Punonjës Task-Force, Bashkia Tiranë për periudhën 23 Mars 2017-7 Korrik 2017;
- Specialist në Drejtorinë e Bashkëpronësisë dhe Ad. të NjA-ve, Bashkia Tiranë për periudhën 21 Korrik 2017-1 Mars 2018;
- Specialist, Bashkia Tiranë për periudhën 01 Mars 2018-11 Shkurt 2019;
- Specialist me kontratë të përkohshme ASHK për periudhën 29 Korrik 2019-31 Dhjetor 2019;
- Vërtetim, Konsulent pranë shoqërisë ELBAVO për periudhën 6 Janar 2006-14 Prill 2008;
- Vërtetim, Konsulent pranë shoqërisë ELBAVO për periudhën 4 Janar 2014-22 Mars 2017;
- Vërtetim, Konsulent pranë shoqërisë ELBAVO për periudhën 12 Shkurt 2019-28 Korrik 2019;

- Vërtetim, Konsulent pranë shoqërisë ELBAVO për periudhën 4 Janar 2020-deri në periudhën e aplikimit.

48. Duke qenë se sipas librezës së punës për z. Eduard Dukaj, evidentohen 8 (tetë) vite punë, si dhe referuar përgjigjes së Institutit të Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr.7674/1, datë 13.12.2021 nga ku rezulton se për kandidatin Eduard Dukaj janë derdhur kontribute për periudhën Janar 2012- Janar 2020, Komiteti përmes emailit të datës 24.02.2022, protokolluar me shkresën nr. 4259/5, datë 24.02.2022, ka vendosur t'i kërkojë kandidatin, duke i lënë atij një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, bazuar në pikën 16, të Kreut III, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", në lidhje me:

1. Arsyet dhe shkaqet mbi mosderdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi;
2. Përshkrimin e hollësishëm të llojit të punës, detyrat, si dhe aktet procedurale që keni draftuar, konceptuar dhe nënshkruar gjatë gjithë kohës që keni qenë i punësuar si Konsulent Jurist pranë këtij subjekti privat;
3. Përshkrim i hollësishëm i punës, i cili duhet të lëshohet me nënshkrimin dhe vulën e subjektit privat ELBAVO sh.p.k, si dhe të përcillni aktet procedurale që faktojnë veprimtarinë konkrete të ushtruar nga ana juaj si jurist gjatë periudhës së punësimit pranë subjektit ELBAVO sh.p.k.

Njoftimi për përcjelljen e dokumentacionit provues iu njoftua kandidati Eduard Dukaj me email datë 24.02.2022 (i cili administrohet në dosjen e aplikimit të kandidatis).

49. Me shkresën nr. 4259/7, datë 11.03.2022, kandidati Eduard Dukaj, dorëzoi dokumente shkresorë, sikurse janë shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., të cilat provojnë faktin se ai ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- Konsulent pranë shoqërisë ELBAVO 6.01.2006-14.04.2008
- Konsulent pranë shoqërisë ELBAVO 4.01.2014-22.03.2017
- Konsulent pranë shoqërisë ELBAVO 12.02.2019-28.07.2019
- Konsulent pranë shoqërisë ELBAVO 4.01.2020-21.10.2021.

Nga tërësia e dokumentacionit shtesë të dërguar nga kandidati Eduard Dukaj si dhe sqarimet që ai ka dhënë drejtuar ILD-së, rezulton se që nga 6.01.2006 që ka filluar të punojë si konsulent pranë shoqërisë ELBAVO, në përgatitjen dhe draftimin e kontratave të sipërmartjes, periudha totale e punësimit shkon **15 vite e 8 muaj e 5 ditë. Kandidati sqaron se për periudhën mbi shtatë vjeçare që ka punuar pranë subjektit ELBAVO nuk ka pasur dijeni për mosderdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.**

50. Bazuar në sqarimet dhe dokumentacion e paraqitur nga kandidati Eduard Dukaj, Komiteti, konstaton se për periudhën 06.01.2006-14.04.2008 ka punuar si konsulent, që të konsiderohet se ka ushtruar profesionin e juristit duhet që gjatë kësaj periudhe të kishte përfunduar edhe arsimin e lartë në drejtësi. Ndërkohë nga diploma e fituar pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër, që ka depozituar kandidati Eduard

Dukaj, si dhe shënimet e vendosura në librezën e punës, vërtetohet se ai ka marrë titullin “Jurist” në sezonin e verës të vitit 2007. Nga çasti i diplomimit si “Jurist” dhe deri në çastin e aplikimit në ILD për një vend pune si inspektor jomagjistrat, rezulton se z. Eduard Dukaj ka 14 vite e pesë muaj. Nëse do të marrim të mirëqenë të gjithë këtë periudhe kohore se ai ka ushtruar profesionin e juristit, përtej mungesës së shënimeve në librezën e punës apo edhe derdhjes të kontributeve shoqërore në DRSSH, duke mbajtur parasysht edhe praktikën e konsoliduar që ka krijuar në raste të ngjashme institucione të tjera kushtetuese.

51. Referuar kuadrit ligjor në fuqi, i cili në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 82, të ligjit nr. 80/2015, ka ekuivalentuar të gjitha diplomat si të vlefshme për hyrjen dhe ushtrimin e profesioneve të lidhura me profilin e arsimit juridik, Është shumë e rëndësishme të theksohet se për ushtrimin e një profesioni sikurse është ai i juristit, në të gjitha format që lejon legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe dhënien e konsulencës duhet që kjo vjetërsi të fillojë nga çasti i diplomimit, i cili është kusht mëse i domosdoshëm që e legjitimon çdo student të diplomuar të regjistrohet si asistent avokat, jurist në ente publike dhe private, përmbarues, noter si dhe çdo aplikim tjetër në organizata ndërkombëtare, etj. Çdo lloj punësimi i kandidatit Eduard Dukaj, para periudhës të verës 2007, pavarësisht faktit se nuk ka derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore nuk mund të vlerësohet si periudhë punësimi si “Jurist”, pa pasur ende titullin përkatës të lëshuar nga institucion i arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit si një kusht “*sine qua non*”. **Për më tepër periudha e punësimit të kandidatit pranë subjektit ELBAVO, nga 2006 -2007, nuk do të thotë se ka fuqi prapavepruese dhe i shtrin efektet e veta për ta konsideruar kandidatin z. Eduard Dukaj se ka punuar në profesionin e juristit edhe para periudhës së diplomimit, që prej datës 06.01.2006.**
52. Duke qenë se kandidati është diplomuar në vitin 2007 dhe në përputhje me parashikimet e bëra në, neni 99/2, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e Lartë”, Diplomat e nivelit të dytë (DND) dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë (DIND), që kanë grumbulluar në studimet universitare, së paku, 300 kredite, të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare “Master i shkencave” dhe “Master i arteve të bukura”, çdo marrëdhënie punësimi që lidhet me përvojën si jurist do të llogaritet si përvojë në profesion pas momentit të diplomimit.
53. Gjithashtu edhe sipas, ligjit në fuqi, konkretisht nenit 124/2 i Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “*Diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat “Master i shkencave”.*
54. **Bazuar sa më sipër, përfshirë edhe sqarimet dhe dokumentacionin shtesë të depozituar nga kandidati Eduard Dukaj, Komiteti konstaton se kandidati nuk plotëson kushtin e përvojës prej të paktën 15 viteve në punë si “jurist”, të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "c", e ligjit nr. 115/2016.**

55. Për sa i përket urdhërimeve të nenit 209, pika 6, germa "ç", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", ku kërkohet që kandidati për inspektor jomagjistrat, të mos ketë ushtruar në mënyre aktive, profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit është kthyer përgjigje nga Dhoma Kombëtare të Avokatisë me shkresën 333 prot., datë 22.12.2021. Në bazë të kësaj përgjigje rezultoi se "Eduard Dukaj, ka fituar titullin avokat dhe është mbajtës i licencës me nr. 7949, të vitit 2014. Prej këtij viti dhe në vazhdim nuk ka ushtruar profesionin e avokatit, parashikuar nga neni 7 i ligjit nr. 55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë".
56. Sa më sipër në lidhje me urdhërimet e nenit 209, pika 6, germa "ç", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", rezultoi se kandidati Eduard Dukaj, plotëson këtë kriter të ligjit pasi nuk ushtron profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë, të paktën dy vitet e fundit para kandidimit.
57. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, gjerat "d", "dh", "e", "ë" dhe "f", të ligjit nr. 115/2016, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Eduard Dukaj, në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si dhe atë të mbërritur nga Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.
58. Në neni 209, pika 6 germa "d" e ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët "d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi". Nga dokumentacioni që është administruar në dosjen e kandidimit, Komiteti konstaton se kandidati Eduard Dukaj, nuk rezultoi të jetë dënuar. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.
59. Gjithashtu, lidhur me kriterin e përcaktuar në nenin 209, pika 6, germa "d" e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 13028/1 prot., datë 10.12.2021, jep informacionin se për shtetasin Eduard Dukaj "Rezultoi se nuk ka shënime në sistem, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë".
60. Në nenin 209, të pikës 6, germa "dh" e ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët "dh) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit". Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshi këtu dhe formularin e vetëdeklarimit, rezultoi se kandidati Eduard Dukaj, nuk rezultoi të ketë mbajtur funksione politike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

61. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit në bazë të nenit 209, pika 6, germa "e", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", kandidati Eduard Dukaj ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta" parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.
62. Bazuar në përgjigjen nr. 1886/1 prot, datë 31.12.2021 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, është administruar vendimi nr.544, datë 29.12.2022, nga ku rezulton se kandidati Eduard Dukaj, nuk është subjekt i ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentat e ish Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "e" të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.
63. Në nenin 209, pika 6, germa "ë" e ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati "ë) të deklarojë se nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi sekret, në kohën e kandidimit;" nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë këtu dhe formularin e vetëdeklarimit në dosjen e kandidimit, Komiteti konstaton se kandidati Eduard Dukaj, nuk rezulton të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi sekret, në kohën e kandidimit, në kohën e kandidimit. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.
64. Në nenin 209, pika 6, germa "f" të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët "f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.". Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshi këtu dhe formularin e vetëdeklarimit, rezulton se kandidati . Eduard Dukaj, nuk rezulton të jetë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata në kohën e kandidimit. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.
65. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet me sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jomagjistrat, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vjen në përfundimin se ndaj kandidati Eduard Dukaj duhet të vendoset ndalimi i kandidimit, në vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021, pasi kandidati nuk ka kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe personave të lidhur sipas VKM nr.536/2019, si dhe nuk plotëson kriterin e përvojës së punës si jurist të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, parashikuar në nenin 209, pika 6, germa "c" e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar,

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, pikave 27/b, 28 shkronja a) dhe b), 30, 31, 72, 73, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve

V E N D O S I:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Eduard Dukaj, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datë 30.09.2021.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Eduard Dukaj.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR


Julian Zonja

KRYETAR


Besnik Maho

ANËTAR


Joana Asimi

